



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 2 prot.

Kamëz, më 22.01.2024

V E N D I M

Nr 02 Datë 22/01/2024

MBI

**“PËRCAKTIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE
SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.01.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.82 Datë 13.12.2023 në mbështetje të pikës 1, germa "a" dhe pika 2 të nenit 113 të Kushtetutës; Nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 29, pikat 3 dhe 4, nenit 33, pika 1, nenit 54, shkronja "k" dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"; Nenit 5, nenit 6 shkronja "b", nenit 10, pika 3, nenit 13, pika 1, shkronja "a", nenit 14, pika 4, nenit 20, shkronja "dh" dhe nenit 37, pika 1, të Ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative"; Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; Ligjit nr. 89, datë 22.12.2022, "Për Policinë Bashkiake"; Nenit 5 pika 1, nenit 10, nenit 12, nenit 23, nenit 29 dhe nenit 38, të Ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar; Nenit 11, nenit 12, nenit 27, nenit 35, nenit 37 dhe nenit 38, të Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave"; Nenit 3 pika 32, nenit 18 pika 3, nenit 20 pika 1 dhe nenit 31, pika 12, të Ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar; Vendimit nr. 99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", i ndryshuar; Nenit 4, 8 pika 4, nenit 12, nenit 18 pika 1.2, nenit 29 pika 1, nenit 32 pika 1, shkronja "a", "b" dhe "s" dhe nenit 34, të Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të ndryshuar; Nenit 4, pika 1, shkronja "c" të Ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, si dhe pika 7.7 shkronjat "m" dhe "n" dhe pika 7.8 shkronja "f" të Shtojcës 1 bashkëlidhur këtij ligji; Udhëzimin nr. 5, datë 26.11.2010 "Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis"; Nenit 66, nenit 73 dhe nenit 76, të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Vendimit nr. 1096, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike"; Udhëzimit nr. 230, datë 20.03.2013, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e funksioneve dhe detyrave specifike të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore" dhe neni 34 i "Rregullores së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

administrimit te bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit", miratuar me Vendimin nr. 447, datë 16.06.2010 të Këshillit të Ministrave, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores për përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Kamëz.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI